



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-217397/22 dt.11.10.2022, të pronareve Hasan Dërmaku, Habim Dërmaku, Sebush Dërmaku, Jeton Dërmaku, “Pozhegu Brothers” sh.p.k., nga Prishtina, dhe investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesën “C11/A4” dhe ndërtesën “C11/A5”, dhe ndërtuar në kuadër të bllokut urban “C-11”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në rr. “Hasan Jashari”, dhe “Muharrem Fejza”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 11.01.2023, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** pronareve Hasan Dërmaku, Habim Dërmaku, Sebush Dërmaku, Jeton Dërmaku, “Pozhegu Brothers” sh.p.k., nga Prishtina dhe investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-217397/22 dt.11.10.2022, përdorimi i ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “C11/A4” me etazhitet 2B+P+8, dhe Ndërtesa “C11/A5” me etazhitet B+S+P+9, të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-262741 dt.03.06.2015, në emër të Elhame Pllana, Albane Smajli, Hamzi Kurteshi, Jeton Dërmaku, Habib Leci, Habim Dërmaku, Sebush Dërmaku, Alush Zariqi, Jahir Ahmeti, Brahim Buzuku, Feti Gashi, Hysen Hajdini, Habib Leci, Hasim Dërmaku dhe Fadil Grajçevci nga Prishtina dhe investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k., dhe Konkuluzionit për Nryshim Plotësimin e Vendimit 05 Nr. 351-262741 dt.03.06.2015, me numër të protokollit 05 Nr. 035-213542 dt.01.09.2016, në emër të Habib Leci, Hasim Dërmaku, Jahir Ahmeti, Sebush Dërmaku, Hasan Dërmaku, Habib Dërmaku, Naim Murati, Qamil Hajrizi, Agron Stublla, Fadil Grajçevci, Feti Gashi, Hysen Hajdini dhe investitorit “Pozhegu Brothers” sh.p.k., në parcelën kadastrale nr. 01591-0, ZK Matičan, konkretisht në kuadër të bllokut urban “C-11”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë.

**II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Hasan Jashari”, me numrin: 12,14, 16, 18 dhe 20, ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese, Ndërtesa “C11/A4”, në rrugën “Muharrem Fejza”, me numrat: 86, 88, 90, 92, 94, 96, 98 dhe 100, Ndërtesa “C11/A5”, në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të tyre në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

## A r s y e t i m

Pronarët pronareve Hasan Dërmaku, Habim Dërmaku, Sebush Dërmaku, Jeton Dërmaku, "Pozhegu Brothers" sh.p.k., nga Prishtina, me investitor "Pozhegu Brothers" sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qemajl Pozhegu nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-217397/22 dt.11.10.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa "C11/A4" me etazhitet 2B+P+8, dhe Ndërtesa "C11/A5" me etazhitet B+S+P+9, e ndërtuara në kuadër të bllokut urban "C-11", të Planit Rregullues "Mati 1", konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 01591-0, ZK Matiqan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-262741 dt.03.06.2015, në emër të Elhame Pllana, Albane Smajli, Hamzi Kurteshi, Jeton Dërmaku, Habib Leci, Habim Dërmaku, Sebush Dërmaku, Alush Zariqi, Jahir Ahmeti, Brahim Buzuku, Feti Gashi, Hysen Hajdini, Habib Leci, Hasim Dërmaku dhe Fadil Grajçevci nga Prishtina dhe investitorit "Pozhegu Brothers" sh.p.k., dhe Konkuluzionit për Nryshim Plotësimin e Vendimit 05 Nr. 351-262741 dt.03.06.2015, , në emër të Habib Leci, Hasim Dërmaku, Jahir Ahmeti, Sebush Dërmaku, Hasan Dërmaku, Habib Dërmaku, Naim Murati, Qamil Hajrizi, Agron Stublla, Fadil Grajçevci, Feti Gashi, Hysen Hajdini dhe investitorit "Pozhegu Brothers" sh.p.k., me numër të protokollit 05 Nr. 035-213542 dt.01.09.2016, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-187433/21 dt. 21.09.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuarësit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografijë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Krenare Kadriu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Rexhep Saliu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Violeta Hoxha; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Agim Binaku; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Korab Lushta; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Arban Shala; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Burim Halilaj me nr. të licensës 195;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, si dhe Raportin e Inspektimit Final konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikatë. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-217397/22 DT. 11.01.2023**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  
*B. Vllasaliu*

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi  
*N. Krasniqi*

Drejtori,  
Arber Sadiki  
*A. Sadiki*



